


Bashkia Krujë



Raporti Performancës 2020



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Krujë.

https://public.tableau.com/shared/T3MJQB3CG?:display_count=y&:origin=viz_share_link

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Krujë me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Të dhëna të përgjithshme	5
Burimet e Financimit.....	6
Shpenzimet buxhetore.....	7
Investimet.....	8
Treguesit Financiar	9
Administrimi i bashkisë.....	10
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët.....	12
Furnizimi me ujë.....	13
Shërbime publike vendore.....	15
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	17
Rrjeti rrugor rural	20
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	22

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Treguesit kyç financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave.** Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave. Me pak ndryshime raporti tregon sesa shpenzon bashkia për të ofruar një Lek shërbime publike.
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara

nga viti i kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për bashkinë pasi tregon se ajo nuk mbështetet në burime të jashtëme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.).

- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre.** Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve.** Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave.** Huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një normë e ulët tregon se bashkia është e aftë t'a paguajë borxhin sipas afatit të caktuar. Një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do t'i duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin.
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave.** Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj.). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikën sociale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim




E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Bashkia Krujë



Bashkia Krujë e pozicionuar në qendër të vendit përbëhet nga 6 Njësi Administrative: Kodër-Thumanë, Bubq, Fushë Krujë, Nikël, Krujë, Cudhi me sipërfaqe prej 339.02 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Krujës. Popullsia e bashkisë numëron 59,814 banorë (sipas të dhënave të Censurit) me një përfaqësim gjinor të barabartë 50% femra dhe 50% meshkuj. Bashkia ka një numër total familjesh prej 15,000 nga të cilat 35% në pjesën urbane dhe 65% në pjesën rurale të bashkisë. Rrjeti rrugor prej 120 km linear shtrihet në rreth 18.9 km në pjesën urbane të saj. Gjatë vitit 2020 u shënuan **828 lindje dhe 670** vdekje duke pasur një raport pozitiv të rritjes së popullatës për gjithë bashkinë.

Bashkia drejtohet në mandatin e **dytë** të tij nga Kryetari **Artur Bushi**, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore morën pjesë rreth 29,89% e zgjedhësve.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

Është për t'u theksuar se gjatë këtij viti bashkia i ka ardhur në ndihmë familjeve të dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë përfitur bonos (grant për qeranë e përkohshme) si edhe ndërtimin e banesave apo apartamenteve si financim nga qeveria qendrore nëpërmjet bashkisë. Shumat totale e shpenzuar në programin për mbështetjen sociale të familjeve dhe fëmijëve ishte 1.5 miliardë lekë të disbursuara deri në fund të vitit 2020 nga vetëm 0.3 që ishte në vitin 2019, pra rreth 4.5 herë më shumë sesa një vit më parë.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)		FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
		1,419,501	1,666,754	3,052,213	3,088,348	99%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat lokale	113,679	145,115	180,999	179,864	100.63%
	Të ardhura nga tarifa vendore	128,642	80,214	51,602	77,888	66.25%
	Të ardhura nga taksat e ndara	21,319	29,482	40,988	46,600	87.96%
	Të ardhurat e tjera	76,818	76,328	30,277	35,648	84.93%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e pakushtëzuar	265,083	276,863	1,412,551	1,412,551	100.00%
	Transferta e kushtëzuar	689,866	719,163	997,520	997,521	100.00%
	Trasferta specifike	124,094	139,209	139,887	139,887	100.00%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion	0	200,380	198,389	198,389	100.00%
	Trashëgimi me destinacion	0	0	0	0	





Figura 1. Pesha e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet në rreth 80% nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit luhaten në kufijtë 10-23% të të gjitha të ardhurave të bashkisë. Edhe pse një vit jashtëzakonisht i vështirë 2020 burimet e financimit shënuan rritje kjo prej kontributit të rëndësishëm të transfertave të qeverisë qendrore, kështu:

- ☀ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 83% kundrejt vitit 2019 ku ato nga taksat, dhe tarifat lokale u ulën me 8%;
- ☀ Totali i burimeve të financimit të bashkisë u realizua në masën 99% kundrejt planit për vitin 2020.

Shpenzimet buxhetore




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 shënuan rritje kundrejt vitit 2019 me rreth 9%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2020 ishte rreth 89%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Kujdes social për famiëjet dhe fëmijët*
- ✿ *Furnizimi me ujë*
- ✿ *Shërbime publike vendore*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Rrjeti rrugor rural*
- ✿ *Arsimi i mesëm i përgjithshëm*
- ✿ *Planifikimi, menaxhimi, administrimi*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
			356,656	470,770	78%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 366 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2019 investimet janë ulur me rreth 37% kjo shpjegon ndër të tjera edhe uljen e kontributetit të tyre në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 78%. Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 tregojnë se:

- ✿ Në fund të vitit 2020 investimet zënë rreth 15% të buxhetit të bashkisë nga 40% në vitin 2019
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, furnizimin me ujë të pijshëm, blerje kazanash për grumbullimin e mbetjeve urbane, rikonstruksioni shkollës së mesme në Kastrioti në Krujë dhe asaj Shote Galica në Fushë-Krujë, shkollat e arsimit bazë dhe parashkollorit, blloqe pallatesh e banesash, projektet e rindërtimi pas tërmetit të dhjetorit 2019, sistemin e vaditjes dhe kullimit; etj.

Treguesit Financiar

Treguesit Financiarë të shprehur në %	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	TRENDI I PERFORMANCËS
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave				1.8%	↓
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	27.9%	39.5%	15.4%	17.7%	↓
Norma e shpenzimeve korente ndaj totalit të shpenzimeve	72.1%	60.5%	84.6%	82.3%	↓
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	29.5%	24.1%	63.4%	56.4%	↑
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	24.0%	19.9%	10.0%	11.0%	↓
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave	17.1%	15.0%	8.0%	8.0%	↑
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	85.9%	88.1%	77.7%	86.3%	↓

Dy fjalë mbi treguesit kyç financiarë

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.


Përgjatë vitit 2020 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- ✱ Rritja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi
- ✱ Rritja e peshës së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave
- ✱ Ulja e peshës së investimeve dhe rritja e peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✱ Ulja e të ardhurave nga burimet e veta të financimit në totalin e të ardhurave
- ✱ Ekzekutimi i buxhetit në një nivel më të ulët kundrejt totalit të fondeve të disponueshme.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	97,527	4%	64%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		0	13	0
↑	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	12.7	13.3	4.4	3.6
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)			1.4	

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ditë trajnimi në total			17	
Numri total i personave të trajnuar			12	

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë (në mijë lekë)			67,025	
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë			13	
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	66	73	16	20
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	354	376	97	376
Numri total i punonjësve të bashkisë	518	551	366	551

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 64% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të përmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✿ Është rritur monitorimi i proceseve të brendshme në bashki e për rrjedhojë janë dhënë masa administrative për të gjithë ata punonjës që janë gjetur me shkelje të kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës. Janë marrë rreth 13 masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Është rritur numri mesatar i ditëve të trajnimit për një person të trajnuar;
- ✿ Është ulur numri i personave që kanë levizur nga puna duke rritur qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Administrimi i bashkisë			468	9,105	0%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje kompjutera , printera , fotokopje	1,605	0		0	
Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike per Bashkine Kruje	0	0		300	
Blerje pajisje ad e bashkise kruje	170	0		0	
Blerje pompe zhytесе per njesine administrative Bubq	0	0	468	500	93.4%
Blerje porte me piston elektronik	0	241		0	
Blerje total station per Drejtorine e Planifikimit të Territorit	0	0		800	
Fond projektesh	0	0		10,000	
Kolaudim Rikonstruksion Godina e Bashkisë	0	0		42	
Mbikqyrje :Rikonstruksion Godina e Bashkisë	47	0		0	
Rikonstruksion Godina e Bashkisë	7,283	0		0	

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	1,503,608	63%	100%



Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korente dhe investime

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për familjet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 100% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 63% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur me mbi 4 herë mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë, sidomos në një vit të vështirë pandemik dhe me pasoja të rëndë të tërmetit të nëntorit 2019. Më konkretisht ky shërbim ka ofruar mbështetje për:


- ✿ Familje dhe fëmijë në nevojë
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Fëmijë në qendra ditore
- ✿ Gra dhe fëmijë viktime të dhunës

Ndërkohë që për fëmijët e shërbyer në çerdhe dhe kopshte është ulur numri i tyre si rrjedhojë edhe e situatës pandemike ku prindërit janë frenuar në frekuentimin si më parë të këtyre institucioneve. Të dhënat teknike të këtij shërbimi mungojnë por administrata do të grumbullojë sa më shpejt dhe azhurnojë këtë raport përkatësisht.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët			1,384	1,384	100%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje pompe uji	89.0				
Blerje soba me dru zjarri	527.0				
Rikonstruksion i çerdhes nr 2 Krujë	660.0				

Furnizimi me ujë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	214,294	9%	100%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investime

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Popullsia totale e bashkisë	81,856	82,572	82,572	82,572

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e pëprballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në masën 100% të planit 2020. Bashkia kontribuon me investime për të përmirësuar shërbimin kryesisht në zonat rurale pasi ky shërbim është i konsoliduar tashmë në pjesën urbane të bashkisë. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Investimet kapën vlerën mbi 194 milionë lekë, të cilat zënë rreth 9% të buxhetit të bashkisë. Performanca e këtij shërbimi tregon se:



- ✿ Ruhet mbulimi me shërbim për të njëjtën popullatë si deri vitin e kaluar por shifrat do të përmirësohen me vënien në funksionim të sistemit të ri ujësjellës për zonat rurale.
- ✿ Mesatarja e kohëzgjatjes së ujit të pritshëm është vetëm 6 orë ujë të pijshëm (mesatarisht për të dyja zonat urbane dhe rurale së bashku). Kohëzgjatja e furnizimit me ujë ka rënë nga viti në vit (nga mbi 8 orë mesatarisht që ishte në vitin 2018) kjo për shkak të futjes në zonën e mbulimit me shërbim të një territori më të madh tashmë i cili nuk mbulohej fare me shërbim më parë.

Duke qenë se ky është një shërbim në zgjerim bashkia do të mbledhë dhe raportoje të dhëna për sa më sipër duke filluar që nga viti 2021.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Furnizimi me ujë			194,510	194,510	100%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kolaudim Ndertim kuz dhe ndricim rrugoril rruges Kodheli	0	0		10	0%
Kolaudim Ndertim Kuz Kameras ,Fshat Fushë-Kruje	0	0	5	5	100%
Kolaudim Ndertim Kuz Kameras ,Fshat Fushë-Kruje 2	0	0	6	6	100%
Kolaudim Ndertim KUZ,B Visha dhe sistemim asfaltim i rruges se Pepeve	0	0		7	0%
Kolaudim: Ndertim kuz durma	0	0		38	0%
Kolaudim:Shtim i sasise se furnizimit me uje ne qytetin e krujes	0	0		127	0%
Mbikqyrje Ndertim Kuz ,Sistemim-asfaltim i rrugeve xhafa e doku,njesia Fushë-Kruje	0	0		138	0%
Mbikqyrje Ndertim kuz dhe ndricim rrugor I rruges Kodheli	0	0	36	36	100%
Mbikqyrje Ndertim Kuz Kameras ,Fshat Fushë-Kruje	0	0	91	91	100%
Mbikqyrje Ndertim Kuz Kameras ,Fshat Fushë-Kruje 2	0	0	45	45	100%

Mbikqyrje Shtim I sasise se furnizimit me uje ne qytetin e krujes	0	779	1,156	1,156	100%
Mbikqyrje:Rehabilitim I puseve ekzistuese dhe ndertimi I linjes se transmetimit dhe shperndarjes se ujesjellesit F Kruje			1,086	1,086	100%
Ndertim I linjes se ujesjellesit Bubq	0	0		2,145	0%
Ndertim Kuz ,Sistemim-asfaltim i rrugeve xhafa e doku,njesia Fushë-Kruje	0	0		3,876	0%
Ndertim kuz dhe ndricim rrugor i rruges Kodheli	3,586	0	432	432	100%
Ndertim kuz durma	18,188	0			
Ndertim Kuz Kamas, Fshat Fushë-Kruje 1	0	1,820	921	921	100%
Ndertim Kuz Kamas, Fshat Fushë-Kruje 2	0	0	1,570	1,570	100%
Ndertim kuz kopshti Fushe-Kruje	780	0			
Ndertim KUZ,B Visha dhe sistemim asfaltim i rruges se Pepeve	0	0	1,938	1,960	99%
Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndertimi i linjes se transmetimit dhe shperndarjes se ujesjellesit Fushë-Kruje			117,775	117,775	100%
Shtim i sasise se furnizimit me uje ne qytetin e Krujes	0	76,633	70,000	70,000	100%
Studim Projektim Uji i pijshem	4,787	4,787			

Shërbime publike vendore



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	14.00	14.00		14.00
Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)		0		0

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	32,000	32,000		32,000
Sipërfaqe totale e bashkisë	339	339		339
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2	48	48		48
Trotuare në km linear	16	16		16

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 71% të planit. Bashkia shpenzon rreth 5% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Ruajturi fondin e pemëve dhe bimëve dekoruese të ambienteve publike të gjelbëruara nga bashkia dhe shërbyer hapësirave publike të gjelbërta duke i mirëmbajtur ato;
- ✿ Mirëmenaxhimin e rrjetit të trotuareve inventari i të cilit është rreth 16 km linear;
- ✿ Bashkia ka mirëmbajtur varrezat publike.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Shërbime publike vendore			2,111	7,043	30%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje autoveture per aparatit e administrates			1,998	2,000	99%
Blerje lodrash për park femijesh prane monumentit Falgeo	0	899			
Blerje makineri dhe pajisje per sherbimet publike	766	0			
Blerje mjete e makineri pune për Drejtorinë e Shërbimeve			113	113	100%
Blerje pajisje per institucionet arsimore	100	0			
Blerje pompe uji AKM	497	0			

Kolaudim: Projekte per permiresimin e kushteve te banimit per komunitetet e pafavorizuara ne Bashkine Kruje	0	0	22	
Kolaudim: Rikonstruksion i ambulances Tapize Nikel	0	0	5	
Kolaudim:Permiresim i kushteve te banimit per komunitetin rom dhe egjiptjan	0	0	52	
Kolaudim:Rehabilitim i skemes ujtese ne rezervuarin thumane	0	0	41	
Kolaudim:Riparim dhe rrethim varrezave te Deshmoreve Kruje	0	0	2	
Mbikqyrje Rehabilitim perforcim banesash	0	183	0	
Mbikqyrje Rikonstruksion i ambulances Tapize Nikel	0	26	0	
Mbikqyrje:Rikonstruksion banesash per komunitetin rom dhe egjiptjan	0	0	171	
Rehabilitim perforcim banesash	9,749	4,151	0	
Rikonstruksion i ambulances Tapize Nikel	0	1,767	0	
Riparim dhe rrethim varrezash kadia	2,396	0	0	
Shtese kontrate Sistemim -Gjelberim Sheshi kryesor	2,514	5,000	0	
Sistemim - Asfaltim trotuare e gjelberim blloku nr 4	7,000	7,000	13,809	
Sistemim - Gjelberim Sheshi kryesor	2,000	0	1,677	

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	107,197	5%	72%




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
○	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	100	100		100
○	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	14.32	14.29		14.29
○	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	20.66	19.64		19.64

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	348	347	347	347

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	1,584	1,659		1,659
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	1,584	1,659		1,659
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	502	477		477
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	7,191	6,814		6,814
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë (në mijë lekë)	118,104	118,289	106,522	148,483

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 72% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 5% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:


- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë edhe pse një vit i vështirë ku më së shumti mësimi është zhvilluar online;
- ✿ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;

- ✿ Është ulur financimi i institucioneve të arsimit parashkollor dhe atij bazë duke reflektuar ndryshimin e prioriteteve në buxhetin e bashkisë. Investimet synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve, të cilat kanë munguar përgjatë vitit 2020.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			34	7,741	0%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kolaudim: Shkolla Shote Galica Fushe Kruje	0	0		11	
Kolaudim Rikonstruksion i ambjenteve shkollore ne Njesine Administrative Cudhi	10	0		0	
Kolaudim Rikonstruksion i shkolles Kurcaj	0	0	12	12	100%
Mbikqyrje Rikonstruksion i ambjenteve shkollore ne Njesine Administrative Cudhi	27	0			
Mbikqyrje Rikonstruksion i shkolles Kurcaj	0	23			
Mbikqyrje Rikonstruksion shkolla e bashkuar Borizane +palester	350	520			
Rikonstruksion i ambjenteve shkollore ne Njesine Administrative Cudhi	4,204	0			
Rikonstruksion i shkolles Kurcaj	1,874	0	22	22	100%
Rikonstruksion i shkolles se bashkuar Borizane	44,096	0			

Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	89,013	4%	46%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korrente dhe investime

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 40% të planit 2020 në një vlerë prej mbi 128 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 46% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✱ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✱ Janë ulur fondet për infrastrukturën rrugore duke reflektuar kështu ndryshimin në prioritetet e bashkisë për shkak të situatës së veçantë në këtë vit.


Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	121	121		121
• Rrugë rurale të mirëmbajtura	19	19		19
• Rrugë urbane të mirëmbajtura	102	102		102

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	121	121	121	121
• Rrjeti rrugor rural	102	102	102	102
• Rrjeti rrugor urban	19	19	19	19
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë:		229,947	89,013	194,875

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Rrjeti rrugor rural			84,739	84,739	100%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kontrate shtese :'' Zgjerim I rruges hyrese, parkimi dhe rikualifikimi i qendres se qytetit	10,000	31,438	10,000	31,445	32%
Rehabilitim i diges Tapize	0	180,000	24,045	24,445	100%
Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare dhe ndertim palestere Thumane	0	27,208		13,742	0%
Sistemim -Asfaltim i rruges kruje Picrrage(Faza II)	0	0		12,279	0%
Sistemim -Asfaltim i rruges hyrese Thumane	0	16,319	11,493	11,493	100%
Shtese kontrate :'' Zgjerim i rruges kryesore dhe rikualifikim I sheshit mustafa merlika	0	12,200	9,561	9,561	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Gramez -Sukth (Faza II)	0	0		7,991	0%
Studim projektim mbrojtje lumore	1,000	2,000	3,000	7,740	39%
Sistemim -Asfaltim i rruges Superstrada-Varrezat Katolike Derven ,njesia thumane	0	6,557	6,400	6,400	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Stacioni I trenit Murqine	0	3,855	4,500	4,500	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges magaze , kodra e loceve	0	859	3,500	3,500	100%
Shpronetime	451	0		3,358	0%
Sistemim -Asfaltim i rruges se Kishes Rroli dhe rruges lidhese Dukagjin i ri	0	4,378	3,200	3,200	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Ramazan Sherra , Ura e Telit Nikel	0	3,206	3,000	3,000	100%
Sistemim-asfalt i rruges se nj adm Shote Galica si dhe shkolles 9vjecare adem gjeli	0	0	2,949	2,949	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges se sinurit , Fushe Kruje	0	5,957	2,926	2,926	100%
Mbikqyrje Rehabilitim i diges Tapize	0	0	2,836	2,836	100%
Sistemim asfaltim i rruges ''Myftari'' prane burgut te sigurise se larte Nj adm Fushe Kruje	0	0	2,744	2,744	100%
Sistemim-asfaltim i rrugeve te Lagjes Ziri,Fushe Kruje	0	0	2,691	2,691	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Mazhe e Vogel Njesia Bubq	0	1,613	2,500	2,500	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges MAZHE E MADHE KORRIKU Njesia Bubq	0	525	2,400	2,400	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Shememi Babaj	0	3,017	2,000	2,000	100%
Riparim me asfaltobeton i rrugeve te demtuara	0	1,266	2,000	2,000	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges se Rryteve	0	463	2,000	2,000	100%
Sistemim -Asfaltim i rruges Abaz Ulliri	0	6,952	1,938	1,938	100%
Sistemim asfaltim i rruges autostrade qender gramez	0	0	1,586	1,586	100%
Asfaltim rruga perroi Brateve shkolla Grepese	0	0		1,525	0%

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	54,897	2%	100%



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e viteve të shkollimit për qytetarët shqiptarë.
(Numri mesatar i viteve të shkollimit të popullatës)

Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi i mesëm i përgjithshëm: korrente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
○	Numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm publik kundrejt numrit total të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (9 vjeçar)	84.1	80.8		80.8
○	Numri mesatar i nxënësve në klasë (Raporti numri total i nxënësve në arsimin e mesëm kundrejt numrit total të klasave në arsimin e mesëm publik)	30.8	30.4		30.4
○	Shpenzime mesatare për një nxënës në shkollën e mesme (total shpenzime) kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin e mesëm publik (Mijë Lekë / Nxënës)	46.61	33.74		18.54

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri klasave funksionale në sistemin e arsimit të mesëm	71	66		66

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Nxënës që përfundojnë sistemin bazë (9-vjeçar)	865	828		828
Nxënës të regjistruar në sistemin e mesëm arsimor (viti 10-12)	2,183	2,006		2,006
Total shpenzime për institucionin e arsimit të mesëm (në mijë lekë)	101,748	67,684	33,873	37,197

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 100% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 2% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✱ Është ruajtur niveli i frekuentimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm, i cili është rreth 81% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë regjistrohen në sistemin parauniversitar;
- ✱ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues (mesatarisht rreth 31 nxënës në një klasë).
- ✱ Është ulur kostoja e një nxënësi të shërbyer në sistemin e arsimit të mesëm të përgjithshëm (pothuajse përgjysmuar) duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi i mesëm i përgjithshëm			50,034	98,245	51%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kolaudim shkolla e mesme Borizane	0	0		51	0%
Kolaudim:Rikonstruksion dhe shtese e shkolles se mesme Kastrioti	0	0		9	0%
Mbikqyrje Rikonstruksion dhe shtese e shkolles se mesme Kastrioti	0	1,923			
Rikonstruksion dhe shtese e shkolles se mesme Kastrioti	0	60,000	50,033	50,033	100%
Rikonstruksion i shkollës së mesme Fushë-Kruje	54,150				